

forum 2015

Seri e analizave "Çka shkoi ters?"

# GABIM PAS GABIMI

Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore



EC Ma Ndryshe për Forumin 2015



Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Projektat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo  
Project of the Kosovo Foundation of Open Society

Seria e analizave “Çka shkoi ters?”

# GABIM PAS GABIMI

**Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore**



EC Ma Ndryshe për Forumin 2015

Autor:  
EC Ma Ndryshe

2013 Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Publikuar nga:  
Forum 2015 - projekt operacional i KFOS  
Imzot Nikë Prela nr. 13  
10 000 Pristina  
Kosovo

Për më shumë informata:  
[info@kfos.org](mailto:info@kfos.org)  
[www.kfos.org](http://www.kfos.org)

# Përmbajtja

<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>5</b>
1. Urbanizmi turbo-kaotik	11
2. Politizimi i trashëgimisë kulturore	15
3. Statusi politik dhe UNESCO	19
4. Marsi 2004 dhe standardi i dyfishtë	23
5. Zonat e Veçanta të Mbrojtura në vend të Zonave Rrethuese	27
6. Ndikimi i misioneve ndërkombëtare	29
7. Plani kombëtar dhe politikat e trashëgimisë kulturore	31
8. Mungesa e inventarit shtetëror	35
9. Intervenimet e vonuara emergjente	37
10. Shkatërrimi i Qendrës Historike të Prizrenit	39
<b>Rekomandime</b>	<b>41</b>



## Përmbledhje ekzekutive

Trashëgimia kulturore vazhdon të mos jetë prioritet i politikave publike në Kosovë. Zyrtarë institucional flasin rrallë ose kurrë për këtë sektor të politikave – përjashtim bëjnë vetëm ditët e fushatave zgjedhore. Qendrat urbane të Kosovës janë shndërruar në gërmadha gjigande betoni, si pasojë e urbanizimit kaotik që nuk i përfill kriteret e planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban. Qytetarët e Kosovës edhe sot vazhdojnë të paguajnë në shumë mënyra dëmet e marsit 2004, derisa trashëgimia kulturore rregullohet me një ligj të pazbatuar që pesë vite dhe në procedurë të ndryshimit.

Mbi krejt këtë situatë të mjerë rëndon fakti i politizimit të skajshëm të trashëgimisë kulturore, i cili manifestohet në dy trajta kryesore: etnizim dhe dimension i fetar. Që të dyja e kanë nxjerrë trashëgiminë kulturore nga kuptimi universal i vlerave të saj dhe e kanë shndërruar në mjet pazaresh politike. Lënja në harresë e shkatërrimit të ndërtimeve tradicionale gjatë luftës, e kthimit të dokumentacionit të monumenteve dhe koleksioneve arkeologjike dhe etnologjike në Kosovë, Momentet si marsi 2004, raporti i Kai Eides, negociatat e Vienës, Plani i Ahtisaarit,

6-pikëshi i Ban Ki Moon dhe presionet e jashtëzakonshme joprofesionale dhe të padrejta të ICO-s janë dëshmitë e një qasjeje të egër politike ndaj trajtimit të vlerave të trashëgimisë kulturore. Si pasojë, Kosova nuk arrin të përfitojë nga potenciali turistik dhe zhvillimor i trashëgimisë kulturore.

Ngjashëm si në shumë sfera të tjera, standardi i dyfishtë është shfaqur edhe në trashëgimi kulturore. Dëmtimi, vandalizimi dhe grabitja e pronave të trashëgimisë kulturore të Kosovës nga forcat serbe gjatë viteve 1998/99 janë lënë në harresë. Mija ndërtime tradicionale të trashëgimisë kulturore të shkatërruara ende nuk janë vlerësuar dhe riparuar. Dokumentacioni i monumenteve, koleksionet arkeologjike dhe etnologjike të muzeve të Kosovës, vazhdojnë të mbahen padrejtësisht në Serbi.

Buxheti shtetëror i Kosovës për kulturën dhe trashëgiminë kulturore është rreth 0.5 deri në 1% e buxhetit vjetor, ndërsa korniza rregulluese e sektorit është jokomplete dhe e pazbatueshme. Shteti i Kosovës sot nuk e di se çfare pasurie të trashëgimisë kulturore posedon. Si rezultat i kësaj, institucionet e shtetit (parakodsalisht) mi-

ratojnë vendime për rrënimin e monumenteve shumë të vjetra, të cilat gjenden në listën e përkohëshme të mbrojtjes (të miratuara nga po të njëjtat institucione). Për më tepër, katër nga monumentet ortodokse të Kosovës që janë në listën botërore të UNESCO-s, si sponsorizues e kanë shtetin e Serbisë. Trashëgimia kulturore është njëra ndër dëshmitë më të qëndrueshme se shteti i Kosovës nuk po funksionin si duhet. Kontributi i bashkësisë ndërkombëtare në këtë – nga administrimi i UNMIK-ut deri tek ICO-ja – është i jashtëzakonshëm.

Lista e gabimeve në ruajtjen dhe mbrojtjen e potencialit të trashëgimisë kulturore është e gjatë, sidomos nëse merret në konsideratë edhe periudha e paraluftës, kur dhe potencialet e trashëgimisë kulturore, përfshirë ato arkeologjike janë trajtuar në mënyrë selektive dhe me metodologji denigruese. Mirëpo, qëllimi i kësaj analize të shkurtër është të adresojë (mos)veprimet institucionale në dekadën e fundit. As ky ngushtim kohor i analizës retrospektive nuk e zvogëlon numrin e gabimeve. Të gjitha problemet e trashëgimisë kulturore janë analizuar përmes këtyre momenteve dhe ngjarjeve: urbanizimi turbo-kaotik, politi-

zimi i trashëgimisë kulturore, statusi politik dhe UNESCO, marsi 2004, zonat e veçanta të mbrojtura, ndikimi i misioneve ndërkombëtare, plani kombëtar dhe politikat e trashëgimisë kulturore, mungesa e inventarit shtetëror, intervenimet e vonuara emergjente dhe shkatërrimi i Qendrës Historike të Prizrenit.

Në pika të shkurtra, kjo analizë konstaton se:

- Qytetet e Kosovës ishin të paafta të parandalonin vazhdimësinë e dëmtimit të trashëgimisë kulturore si pasojë e një vale agresive ndërtimesh, që erdhën si reagim ndaj nevojave të mëdha të krijimit të hapësirave të reja të banimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit,
- Trashëgimia kulturore, për shkak të politizimit të skajshëm, asnjëherë nuk ka arritur të trajtohet në mënyrë adekuate, përmes profesionistëve dhe hartuesve të politikave publike, ndërsa efekti më i rëndë anësor është pengimi i themelimit të sistemit institucional për menaxhimin e trashëgimisë kulturore,
- Institucionet e shtetit të Kosovës nuk kanë arri-

tur asnjëherë të krijojnë një strategji shtetërore në raport me UNESCO-n, ndërsa duke u thirrur në anëtarësimin në OKB, çështja e UNESCO-s është trajtuar më tepër si pasojë direkte e atij momenti dhe asnjëherë në nivel praktik të gjetjes së mundësive alternative për anëtarësim,

- Ngjarjet e marsit 2004, sado të turpshme dhe të pajustificueshme, kosovarëve u janë fatuar me një çmim të pabesueshëm, përfshi edhe portretizimin e shqiptarëve nga Kai Eide si popull që e rrezikon ekzistencën e monumenteve të lashta të besimit krishterë ortodoks,
- Standardi i dyfishtë i aplikuar pas ngjarjeve të marsit 2004 lidhet me vënjen në harresë të periudhës së mëparshme, faktit se objektet e kultit asnjëherë nuk janë dëmtuar nga qytetarët e Kosovës, dhe mbi të gjitha politizimit të skajshëm të rolit të Kishës Ortodokse gjatë viteve 90 dhe pas luftës në Kosovë,
- Trashëgimia kulturore e vandalizuar dhe shkatërruar nga forcat serbe gjatë luftës ende nuk është sanksionuar dhe vazhdon të mbetet

në harresë e mëshirë të kohës,

- Zonat e mbrojtura të përshkruara në Planin e Ahtisaarit, edhe pse në emër të mbrojtjes së mjediseve rrethuese të pronave të trashëgimisë kulturore nga zhvillimet bashkëkohore, janë instrument i pastër politik, që betonizon dimensionin e etnisë brenda trashëgimisë kulturore,
- Përveç shumë kompromiseve të dhimbshme në raport me Serbinë, në forma të ndryshme, ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare në trashëgiminë kulturore të Kosovës vazhdon edhe sot, ndërsa një pasojë direkte e saj është klasa politike kosovare e gatshme për t'iu bindur të gjitha “këshillave” joprofionale të miqve ndërkombëtar,
- Dështimi i institucioneve shtetërore për të ndërtuar një qasje sistematike ndaj trashëgimisë kulturore, në veçanti mungesa e inventarit shtetëror, një premtim i para dhjetë viteve që nuk është realizuar kurrë, ka prodhuar tensione të vazhdueshme mes interesave konkurruese: mes ruajtjes dhe rritjes, traditës dhe modernizimit, artizanale dhe inovacionit,



- Kosova nuk mund të shpallë në mbrojtje ligjore asnjë pronë të trashëgimisë kulturore, ndërsa lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme është zgjidhje e përkohshme dhe arruese ndaj problemit të madh në këtë sektor,
- Fondet publike në dispozicion të trashëgimisë kulturore në përgjithësi, dhe rrjedhimisht ato për intervenime emergjente në veçanti janë nën minimumin e nevojave të këtij sektori, ndërsa praktika e intervenimeve emergjente bëhen pa plane dhe standarde profesionale, përmes kompanive të ndërtimit, të cilat nuk i kanë as licensat e nevojshme për të kryer intervenime në trashëgimi kulturore, dhe
- Prizreni, përveç shumë rasteve tjera, është një shembull tipik i dështimit të institucioneve të shtetit në fuqizimin e mbrojtjes së potencialëve të trashëgimisë kulturore, pasi që degradimi i vlerave të Qendrës Historike të qytetit ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të kornizës ligjore nga të dyja nivelet e qeverisjes.

Ndërsa këto janë rekomandimet e analizës:

- *Për Kuvendin e Kosovës dhe Autoritetet e Trashëgimisë Kulturore:* Hartimi i Planit Kombëtar në linjë të integruar për Trashëgiminë Kulturore, dhe Shpallja e pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje,
- *Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë Sporti:* Përgatitja e Strategjisë/Programit për aplikim të konservimit të integruar të trashëgimisë kulturore, Mbikëqyrje efektive e respektimit të parimeve të trashëgimisë kulturore në komuna, Përfundimi i inventarit shtetëror dhe mbrojtja e përhershme e trashëgimisë kulturore, Ngritja e kapaciteteve dhe rritje e buxhetit për trashëgimi kulturore,
- *Për Qeverinë e Kosovës:* Kushtëzimi i dialogut me Serbinë me kthimin e artefakteve të grabitura, Vlerësimi i mundësive alternative për vendosje të marrëdhënieve me UNESCO-n, Intensifikimi i aktiviteteve rreth procedurës për ratifikimin e konventave ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, Prioritizimi i trashëgimisë kulturore si politikë publike me interes kombëtar, dhe Plotësimi i programeve

shkollore me lëndën e trashëgimisë kulturore,

- *Për komunat e Kosovës:* Respektimi i përpiktë i Instituteve për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Hartimi i planeve lokale të trashëgimisë kulturore, Koordinim efektiv mes drejtorive për urbanizëm dhe inspektoratit, Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane, dhe Rrënimi i ndërtimeve pa leje në qendrat historike të qyteteve,
- *Për bashkësinë ndërkombëtare:* Të kuptojë rolin e saj dhe të ndryshojë qasjen kundrejt trashëgimis kulturore të Kosovës, Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe Depolitizimi i trashëgimisë kulturore,
- *Për shoqërinë civile:* Mobilizimi i grupeve qytetare lokale kundër degradimit urban të qyteteve, dhe Angazhimi në projekte vetëdijësimi mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore.



## I. Urbanizmi turbo-kaotik

Qendrat historike të Prishtinës, Prizrenit e Gjakovës, sot pothuaj nuk ekzistojnë, pasi janë përfshirë nga ndërtimet e reja dhe të pakontrolluara pas lufte, krahas dëmeve shkatërruese të shkaktuara gjatë luftës. Sektori i ndërtimitarisë është ndër sektorët më profitabil të ekonomisë kosovare. Ndërtuesit kanë ngritur qendra tregtare dhe objekte të banimit kolektiv jo vetëm në hapësirat fizikisht të lira të qyteteve, por edhe duke krijuar hapësira të reja ndërtimi përmes rrënimit të objekteve të vjetra. Planifikimi hapësinor (dhe urban) është ndër mangësitë themelore të dy niveleve të qeverisjes, ndërsa ky sektor pothuaj nuk ka komunikim institucional me atë të trashëgimisë kulturore.

Për fat të keq, as trashëgimia kulturore nuk i ka shpëtuar viktimizimit nga sistemi i ri i “vlerave” pas lufte, që karakterizohet me mungesë totale të llogaridhënies e përgjegjësive dhe me kulturë të mosndëshkimit. Në një mjedis të tillë, investitorët në ndërtimtarinë kanë arritur që paratë e fituara në rrugë joformale t’i shpërlajnë përmes ndërtimeve të shumta, gjatë të cilit proces ata i kanë korruptuar edhe zyrtarët e pushteteve lokale të Kosovës. Esencialisht, problemi qëndron në mosndalimin dhe mosndëshkimin e veprimtarisë

ekonomike joformale nga institucionet e shtetit. Rrjedhimisht, është pothuaj absurde të pritet që i njëjti shtet të vendosë rregull dhe të ndalojë aktivitete degraduese ndërtimore në qendrat historike të qyteteve.

Menjëherë pas lufte dhe në vakuumin e përgjithshëm ligjor e institucional,<sup>1</sup> qytetet e Kosovës u përfshinë nga një valë agresive ndërtimesh, që erdhën si reagim ndaj nevojave të mëdha të krijimit të hapësirave të reja të banimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit. Shkaku kryesor i këtij zhvillimi ishte migrimi i brendshëm rural – urban, i cili ka shtuar në mënyrë drastike numrin e popullsisë në qendrat urbane të Kosovës. Përveç mungesës së legjislacionit qendror për planifikim hapësinor, sistemi institucional i Kosovës ishte i papërgaditur edhe në nivelin komunal. Me struktura mjaft të brishta të qeverisjes dhe menaxhimit urban, komunat e Kosovës kishin shumë pak mundësi të kontrollojnë këtë urbanizim kaotik. Për më tepër, ishin vetë zyrtarët komunalë, ata që u përfshinë në mënyrë direkte në shumë parregullsi urbanistike të kësaj periudhe, të cilat me intensitet të ndryshëm vazhdojnë të ndodhin edhe sot.

<sup>1</sup> Zgjedhjet e para lokale në Kosovë janë mbajtur më 28 tetor 2000, ndërsa zgjedhjet e para të parlamentare më 17 nëntor 2001

Njëra nga pasojat më të dhimbshme të këtij procesi ishte ndërtimi i pakontrolluar në zonat që gëzojnë statusin e qendrave historike. Qytetet e vjetra të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës janë ndër më të prekurat, ndërsa këtij fati nuk i kanë shpëtuar as qytetet e tjera të Kosovës. Institucionet e shtetit, në të dyja nivelet e qeverisjes, as sot nuk e kanë krijuar sistemin e koordinimit mes dy sferave të politikave publike, planifikimit hapësinor (dhe urban) dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Me një fjalë, planifikimi hapësinor dhe urban vazhdon të mbetet një sferë e izoluar e hartimit dhe zbatimit të politikave, duke e neglizhuar në tërësi nevojën për të marrë në konsideratë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në nivelin qendror, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i kanë hartuar dhe miratuar të gjitha ligjet dhe politikat e rëndësishme pa e involvuar njëra tjetrën.<sup>2</sup>

Në nivelin komunal, moskomunikimi institucional është edhe më fatal për trashëgimisë kulturore. Pothuaj në të gjitha rastet, drejtoritë komunale

2 Në mesin e katyre ligjeve dhe politikave bëjnë pjesë Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Politika e Konservimit të Integruar të Trashëgimisë Kulturore, Ligji për Planifikimin Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës

të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor dështojnë të koordinohen me Institutet për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Janë konstatuar me dhjetëra raste të shkeljes së pëlqimeve të lëshuara nga institutet, si nga ana e institucioneve komunale, ashtu edhe vetë ndërtuesit. Sektori i ndërtimeve në Kosovë vazhdon të jetë njëri ndër më të përfolurit për keqpërdorime dhe korrupsion.<sup>3</sup> Konkretisht, disa zyrtarë të komunës së Prizrenit dhe disa kompani ndërtimi janë nën hetime nga Prokuroria e Qarkut për parregullsi urbanistike.<sup>4</sup> E njëjta gjendje vlen edhe për Prishtinën, ku disa nga zyrtarët komunalë janë të përfshirë në kaosin urbanistik që e ka kapluar kryeqytetin.<sup>5</sup> Ndonëse zhvillimi i hetimeve nuk paragjykon asgjë mbi vërtetësinë e akuzave, numri i konsiderueshëm i rasteve hetimore është tregues i mirë i parregullsive në urbanizëm.

Vrasja e arkitektit Rexhep Luci në vitin 2000 ishte momenti i paralajmërimit të degradimit urban jo vetëm në Prishtinë. Kjo vrasje nuk

3 EC Ma Ndryshe, Më në fund – hetime për krimin urbanistik në Prizren, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_9.08.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_9.08.pdf)

4 Zëri, Banesat që shpiejnë të krimi, në <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/58630/banesat-qe-shpiejne-te-krimi/>

5 Kosova Sot, Kaosi urbanistik me lejet e komunës, në <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/-kaosi-urbanistik-me-lejet-e-komunes>

është zbardhur kurrë dhe është dëshmi e qartë e mungesës totale të llogaridhënies dhe përgjegjësisë dhe zotërimit të kulturës së mosndëshkimit në Kosovë. Ai kishte pësuar për shkak se kundërshtoi atë që më vonë do të cilësohet si turp i urbanizmit në shumë qytete të Kosovës, ndërsa me kohë do të marrë formën e hetimeve dhe padive për krim të organizuar. Kjo vrasje arriti të amortizojë jo vetëm zyrtarët e komunave, por edhe çdo mundësi të mobilizimit qytetar për mbrojtjen e qyteteve dhe të trashëgimisë së tyre kulturore. Trembëdhjetë vite pas këtij akti, numri i organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në këtë sektor është në mënyrë të papërfillshme i vogël. Në qytetet e Kosovës ende nuk kanë arritur mobilizimi i duhur i qytetarëve për të penguar degradimin e vazhdueshëm të shkaktuar nga grupe të fuqishme interesi, të lidhura edhe me zyrtarë të lartë shtetëror në të dyja nivelet e qeverisjes.



## II. Politizimi i trashëgimisë kulturore

Administrimi ndërkombëtar në Kosovës ka sjellë edhe interpretim të ri të trashëgimisë kulturore. Sot monumentet e trashëgimisë, si kurrë më parë, identifikohen mbi baza etnike dhe fetare. Këto trajta të reja që ka marrë trashëgimia kulturore janë burime permanente tensionesh, ndërsa në nivele politike trashëgimia kulturore vazhdon të jetë objekt pazaresh mes Kosovës dhe Serbisë. Plani i Ahtisaarit ka qenë dokumenti që ka ridefinuar ligjërimin publik mbi trashëgiminë kulturore, duke e forcuar dimensionin etnik të saj.<sup>6</sup> Sot, pothuaj të gjithë në Kosovë e kanë përvetësuar gabimisht këtë ligjërim, duke e inkorporuar etninë serbe në monumente të trashëgimisë ortodokse.

Katër prona të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, të vlerësuara si monumente mesjetare të Kosovës, gjenden në listën botërore të trashëgimisë të UNESCO.<sup>7</sup> Megjithatë, këto monumente dhe të tjerat që i përkasin besimit krishterë ortodoks në Kosovë, janë ndërtuar në rrethana specifike të ndryshme historike, dhe në

vete përmbajnë shtresa të kulturave dhe besimeve më të hershme. Sipas Shkëlzen Maliqit, në kontekstin e tensioneve të larta kombëtare dhe fetare në ish-Jugosllavi, qarqet nacionaliste serbe gjatë viteve '80 kanë bërë një reduktim radikal të qasjes ndaj kësaj trashëgimie, duke e përvetësuar, nacionalizuar dhe politizuar në tërësi.<sup>8</sup> Ky etnizim i monumenteve të trashëgimisë kulturore është në kundërshtim me faktin e thjeshtë që ato janë ngritur si tempuj të kultit krishterë (ortodoks), ndërsa në atë kohë (kryesisht mesjetë) në Kosovë kanë jetuar popuj të ndryshëm të krishterë.

Në rrethana në tilla, trashëgimia kulturore asnjëherë nuk ka arritur të trajtohet në mënyrë adekuate, përmes profesionistëve dhe hartuesve të politikave publike. Politizimi vazhdon të nglufasë çdo potencial zhvillimor të trashëgimisë kulturore, ndërsa efekti më i rëndë anësor është pengimi i themelimit të sistemit institucional për menaxhimin e trashëgimisë kulturore si atribut dhe vlerë universale e njerëzimit. Rrjedhimisht, pronat e trashëgimisë kulturore janë bërë shumë të lëndueshme, pasi që Kosova nuk ka arritur të

6 Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Aneksi V – Trashëgimia fetare dhe kulturore, në [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal\\_-\\_Propozimi\\_gjith%EBp%EBrfshir%EBs\\_-\\_albanian\\_final.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%EBp%EBrfshir%EBs_-_albanian_final.pdf)

7 UNESCO, World Heritage List (World Heritage in Danger), Medieval Monuments in Kosovo, në <http://whc.unesco.org/en/list/724>

8 Shkëlzen Maliqi, Trashëgimia kulturore kundër barbarizimit në Kosovë, në <http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/3274/Trashegimia-kulturore-kunder-barbarizimit-ne-Kosove>



krijojë sistem të mbrojtjes, menaxhimit dhe promovimit të këtyre vlerave. Sipas Liburn Aliut, trashëgimia kulturore duhet të trajtohet si vlerë në vete dhe jo si mjet politik, duke konstatuar se ajo po instrumentalizohet për qëllime të ndarjes së Kosovës.<sup>9</sup>

Nga këto tensione politike nuk kanë mund të shpëtojnë as mbi 1000 artefakte arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës, të cilat janë grabitur nga shteti i Serbisë që nga vitit 1998/99 dhe pas periudhës së luftës. Pas gjithë këtyre viteve, shteti i Serbisë nuk e ka kthyer këtë thesar dhe vazhdon ta mbajë atë në kundërshtim me Konventat e UNESCO-s mbi Mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të Armatosur,<sup>10</sup> Mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit dhe eksportit të paligjshëm dhe transferimin e pasurisë kulturore<sup>11</sup> dhe Ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.<sup>12</sup>

9 Liburn Aliu, diskutime në fokus grupin “Çka shkoi ters në trashëgimi kulturore”, mbajtur më 9 tetor 2012 në Prishtinë

10 UNESCO, Convention for the Protection of Cultural Property in the Event of Armed Conflict with Regulations for the Execution of the Convention 1954, në [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=13637&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13637&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

11 UNESCO, Convention on the Means of Prohibiting and Preventing the Illicit Import, Export and Transfer of Ownership of Cultural Property 1970, në [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=13039&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=13039&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

12 UNESCO, Convention for the Safeguarding of the Intangible

Përveç dështimit për t’i kthyer këto artefakte me kanale politike dhe procese të dialogut me Serbinë, institucionet e Kosovës kanë ngecur edhe në ratifikimin e konventave ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore. Edhe pse zyrtarët e MKRS mbrojnë qëndrimin se ratifikimit të këtyre konventave duhet t’i paraprijë anëtarësimi në UNESCO, ekspertët kanë mendim të kundërt. Sipas Gjejlane Hoxhës “edhe pse nuk jemi pjesë e Kombeve të Bashkuara apo UNESCO-s, askush nuk e ndalon qasjen në këto dokumente. UNESCO publikon të gjitha konventat ndërsa shtetet jo anëtare mund të aderojnë duke pranuar këto praktika të mira ndërkombëtare. Nuk duhet të presim të anëtarësohemi në OKB apo në UNESCO, por duhet të integrohemi tani me futjen e konventave në legjislacion, sepse ato përmirësojnë gjendjen e trashëgimisë.”<sup>13</sup> Në këtë linjë, edhe Isuf Koci argumenton se “me ratifikimin e këtyre konventave, Republika e Kosovës do të bëjë një hap përpara në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me theks të veçantë asaj të luajtshme. Po ashtu, me këto veprime ndërkom

Cultural Heritage 2003, në [http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL\\_ID=17716&URL\\_DO=DO\\_TOPIC&URL\\_SECTION=201.html](http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=17716&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html)

13 Zëri, Shteti nuk ratifikon konventat për trashëgimi, në <http://www.zeri.info/artikulli/4/22/66591/shteti-nuk-ratifikon-konventat-per-trashegimi/>

bëtarizon dhe parandalon eksportin dhe importin e paligjshëm të trashëgimisë së luajtshme.”<sup>14</sup>

---

14 Isuf Koci, Gjendja e trashëgimisë kulturore të luajtshme në Republikën e Kosovës, në [http://mem.rks-gov.net/repository/docs/Gjendja\\_e\\_trashegimise\\_se\\_luajtshem\\_1\[1\]\\_228103.pdf](http://mem.rks-gov.net/repository/docs/Gjendja_e_trashegimise_se_luajtshem_1[1]_228103.pdf)



### III. Statusi politik dhe UNESCO

Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejës, Kisha e Shën Premtës dhe Manastiri i Graçanicës janë katër monumente në Kosovë të cilat në vitin 2006 nga shteti i Serbisë u përfshinë në Listën Botërore të Trashëgimisë në Rrezik të UNESCO-s.<sup>15</sup> Ky realitet nuk ka ndryshuar as pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, për shkak të statusit politik dhe mosanëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ndonëse në aspektin e mbrojtjes, përfshirja në këtë listë është lajm i mirë, në fakt ky paraqet sulm të drejtpërdrejtë ndaj shtetësisë së Kosovës dhe aftësisë së saj për t'u kujdesur për monumentet e trashëgimisë kulturore që gjenden në territorin e shtetit.

Në sesionin e vitit 2011 të Komitetit të UNESCO për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Botërore u diskutua propozimi që këto katër monumente të quhen trashëgimi kulturore e Kosovës.<sup>16</sup> Në këtë takim ndodhi një betejë e ashpër diplomatike, ndërsa ministri i atëhershëm serb i punëve të jashtme, Vuk Jeremic këtë iniciativë e kishte cilësuar si “përpjekje për të vjedhur identitetin

e Serbisë dhe falsifikuar historinë”.<sup>17</sup> Ndonëse iniciativa nuk kishte marrë vota të mjaftueshme, zyrtarë të UNESCO kanë paralajmëruar ngritjen e sërishme të kësaj çështjeje, duke u arsyetuar se mungesa e votave të mjaftueshme për miratimin e propozimit nënkupton vetëm shtyrje kohore, por jo edhe heqje dorë nga ndryshimi i emërimit të këtyre monumenteve.

Megjithatë, një vit e gjysmë pas këtij sesioni të UNESCO, vazhdon të mbetet i njëjti realitet. Për më tepër, Kosova ende nuk e ka arritur as numrin 100 të njohjeve të statusit të saj<sup>18</sup>, ndërsa anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe rrjedhimisht në UNESCO mbeten synime të largëta. Në esencë, debati për trashëgiminë vlerësohet të jetë pjesë e debatit për sovranitet mbi Kosovën. “Në Paris përfaqësuesi i Francës ka insistur se çështja e pavarësisë së Kosovës është tashmë e pakthyeshme, andaj edhe UNESCO duhet ta pranojë realitetin dhe trashëgiminë botërore në Kosovë t’ia lë titullarit

15 UNESCO, World Heritage List (World Heritage in Danger), Medieval Monuments in Kosova, në <http://whc.unesco.org/en/list/724>

16 UNESCO, 18th General Assembly of State Parties, në <http://whc.unesco.org/en/sessions/18GA/>

17 B92, Battle for Serbian heritage in Kosova to continue, në [http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=07&dd=01&nav\\_id=75212](http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2011&mm=07&dd=01&nav_id=75212)

18 Ministria e Punëve të Jashtme, Shtetet që e kanë njohur Republikën e Kosovës, në <http://www.mfa-ks.net/?page=1,33>

të sovranitetit, intitucioneve të Kosovës.”<sup>19</sup> Në një perspektivë optimiste, iniciativat e Francës, Zvicrës, SHBA-së e të tjerëve në nivelet e UNESCO-s për ta mbështetur trashëgiminë kulturore të Republikës së Kosovës janë cilësuar edhe si dëshmi se bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejojë më që problemet e trashëgimisë kulturore dhe çështja e mbrojtjes së saj të vazhdojnë të politizohen.<sup>20</sup>

Institucionet e shtetit të Kosovës nuk kanë arritur asnjëherë të krijojnë një strategji shtetërore në raport me UNESCO-n. Duke u thirrur gjithmonë në kauzën e madhe të anëtarësimit në OKB, çështja e UNESCO-s është trajtuar më tepër si pasojë direkte e atij anëtarësimi dhe asnjëherë në nivel praktik të gjetjes së mundësive alternative. Njëra nga këto mundësitë ka qenë iniciativa e vitit 2008 për përfshirjen e “Eposit të Kreshnikëve” në Listën Botërore të Trashëgimisë të UNESCO-s. Ishte menduar që aplikimin formal ta bëj shteti i Shqipërisë, ndërsa pjesë e këtij aplikimi të jetë

edhe Kosova, pasi që kjo vlerë e trashëgimisë shpirtërore, në aspektin gjeografik përfshin kryesisht territorin e Kosovës.<sup>21</sup> Megjithatë, në fund të vitit 2012 u kuptua se kjo iniciativë duhet të presë edhe ca kohë, pasi që anëtarësimi i Kosovës në OKB përsëri u prezantua si pengesë.<sup>22</sup>

Diskutimi për UNESCO-n ka patur edhe momentet e tij paradoksale. Në vitin 2010, kur Ministria e Kulturës udhëhoqej nga Lutfi Haziri, ai pat deklaruar se “Qeveria e Kosovës është duke e përgatitur dosjen që Prizrenin të kandidojë për mbrojtje nga UNESCO-ja dhe kjo do të jetë edhe një mundësi me e madhe për zhvillimin e qytetit”.<sup>23</sup> Një vit më vonë, këshilltari i Ministrisë të ri deklaroi se nuk ka asgjë konkrete për këtë çështje. Për më tepër ai shpreh habinë e tij duke thënë se “Nuk e di çka ka premtuar Haziri, por në Ministrinë e Kulturës nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me këtë, dhe se nuk do të punohet në këtë drejtim pasi që Kosova nuk është anëtare e

19 Shkëlzen Maliqi në Gazeta Express, Trashëgimia e Kosovës, në <http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/lexo/2679/C4/C14/?cid=1,75,57440>

20 Edi Shukriu në Telegrafi, Pranohet apo jo trashëgimia kulturore e Kosovës nga UNESCO-ja?, në <http://www.telegrafi.com/lajme/pranohet-apo-jo-trashegimia-kulturore-e-kosoves-nga-unesco-jaja-26-4035.html>

21 Izaura Ndoj, Eposi i Kreshnikëve gati për UNESCO, kulturë në rrezik, në <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047101646/titulli/Eposi-i-Kreshnikeve-gati-per-UNESCO-kulture-ne-rrezikIzaura-Ndoj>

22 Panorama, Eposi humb shansin për mbrojtje nga UNESCO, në <http://www.panorama.com.al/2012/09/11/%E2%80%9Ccepisi%E2%80%9D-humb-shansin-per-mbrojtje-nga-unesco/>

23 Zëri, Prizreni në mbrojtje të UNESCO-s, në <http://www.zeri.info/artikulli/4/22/9805/prizreni-ne-mbrojtje-te-unesco-s/>

OKB-së.”<sup>24</sup>

Statusi politik i Kosovës dhe njohja ndërkombëtare kanë qenë arsye të zakonshme të institucioneve të Kosovës. Edhe pse ky fakt politik është përcaktues në raport me anëtarësimin e Kosovës në organizma ndërkombëtarë, institucionet e shtetit kanë dështuar në kërkimin e rrugëve alternative për anëtarësim në UNESCO. Një rast konkret dhe shembull prej të cilit Kosova mund të nxjerrë mësim të mira është ai i Autoritetit Palestinez, i cili në përpjekjet e veta për anëtarësim më të drejtë të plotë në OKB, ka siguruar statusin e shtetit joanëtar. Ky status, Autoritetit Palestinez i ka hapur rrugën drejt anëtarësimin në UNESCO, i cili ndër tjerash iu është ofruar edhe si kompensim për mungesën e anëtarësimin të plotë në OKB.<sup>25</sup>

---

24 Koha Ditore, Hiqet dorë nga futja e Prizrenit në UNESCO, në <http://www.kohaditore.com/index.php/repository/karikaturat/function.require?page=1,5,60141>

25 BBC, Q&A: Palestinians upgraded UN status, në <http://www.bbc.co.uk/news/world-middle-east-13701636>



## IV. Marsi 2004 dhe standardi i dyfishtë

Ngjarjet e marsit 2004 ishin moment përcaktues i fatkeqësisë së trashëgimisë kulturore. Për herë të parë, si rezultat i këtyre ngjarjeve, në raportin e Kai Eide-s në vitin 2005 u artikulua nevoja për “hapësira mbrojtëse” përreth, siç thuhet në raport, “objekteve dhe institucioneve ortodokse serbe” në Kosovë.<sup>26</sup> Rrethojat fizike dhe prezenca polimore e ushtarake u bënë pjesë përbërëse e monumenteve të trashëgimisë, një pamje që iu zhveshi të gjitha karakteristikat dhe vlerat kulturore, historike e fetare këtyre objekteve. Kjo mënyrë e izolimit të monumenteve është në kundërshtim me të gjitha parimet dhe standardet e mbrojtjes aktive dhe efektive të pronave të trashëgimisë kulturore.

Për sanimin e dëmeve të shkaktuara në këto ngjarje u themelua një trup i veçantë, i pagëzuar si Komisioni për Zbatimin e Rindërtimit.<sup>27</sup> Ky komision ishte përgjegjës për programim dhe mbikëqyrje të realizimit të rindërtimit të 34 objekteve të trashëgimisë ortodokse në Kosovë, të cilat u dëmtuan gjatë ngjarjeve të marsit 2004.

26 Raporti i Kai Eide për situatën në Kosovë, në <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>

27 European Commission & Council of Europe, Reconstruction Implementation Commission, në <http://www.coe.int/t/DG4/CULTUREHERITAGE/COOPERATION/RIC/inc/eng/home.html>

Anëtarë të këtij komisioni kanë qenë: Këshilli i Evropës, Kisha Ortodokse Serbe, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës i Serbisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës.<sup>28</sup> Ky organizëm kishte kompetenca vendimmarrëse, ndërsa për një kohë të gjatë ka qenë i vetmi prioritet në sektorin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ndërkaq mijëra ndërtesa tradicionale të vandalizuara dhe shkatërruara gjatë viteve 1998/99 nga forcat serbe nuk u trajtuan apo riparuan, edhe krahas faktit që Tribunali i Hagës për Krime Lufte në ish Jugosllavi, për këto akte shaktërruese dha vlerësimin *krim kundër njerëzimit*.<sup>29</sup>

Ndonëse ngjarjet e marsit 2004 janë vështirë të justifikueshme, pasoja e tyre direkte, raporti i Kai Eides ishte goditje mjaft e fuqishme ndaj shoqërisë kosovare. Ai i portretizon shqiptarët si popull që e rrezikon ekzistencën e monumenteve të lashta të kishës ortodokse. Në raportin e tij,

28 Mekanizmi i RIC, në <http://www.coe.int/t/DG4/CULTUREHERITAGE/COOPERATION/RIC/inc/eng/mechanism.html>

29 International Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Humanitarian Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991, Prosecutor v Vladimir Dordevic, në [http://www.icty.org/x/cases/djordjevic/tjug/en/110223\\_djordjevic\\_judgt\\_en.pdf](http://www.icty.org/x/cases/djordjevic/tjug/en/110223_djordjevic_judgt_en.pdf)



Kai Eide tregon shumë qartë narracionin e etabluar të bashkësisë ndërkombëtare mbi Shqiptarët dhe Serbët si dhe shpërfaq të gjitha paragjykimet dhe stereoptipet mbi konfliktin ndërmjet këtyre dy popujve, identitete e tyre dhe viktimizimin. Eide, ndër të tjera thotë se “ Sot, Shqiptarët e Kosovës demonstrojnë një vetëbesim dhe këmbëngulësi më të madhe: Kuptueshëm, ata janë duke formësuar identitetin e tyre si popullatë shumicë udhëheqëse. Ky identitet, në masë të madhe ndërtohet mbi ngjarje, simbole dhe personalitete kontraverze, shpesh në opozitë me identitetin e Serbëve të Kosovës dhe të komuniteteve tjera”<sup>30</sup>

Në pjesën hyrëse të këtij raporti, Kai Eide deklaron se “serbët e Kosovës janë duke luftuar për të ruajtur identitetin e tyre”, ndërsa për komunitetet e tjera se ato janë duke u margjinalizuar. Konstatimet e tij shkojnë edhe deri në pikën që disa nga këto komunitete janë duke u asimiluar nga popullsia shumicë e vendit.<sup>31</sup> Ndërsa, në pjesën e titulluar “Institucionet dhe monumentet fetare ortodokse serbe”, raporti flet për shkatërrimin e këtyre objekteve nga viti 1999<sup>32</sup>, ndërsa

30 Raporti i Kai Eide, për situatën në Kosovë, pika 7, në <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>

31 Raporti i Kai Eide për situatën në Kosovë, Kontekst, pika 8, në <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>

32 Ky është një tjetër konstatim kundërtë në raportit, pasi që, para

aty për herë të parë artikullohet nevoja për “zonë mbrojtëse” rreth këtyre pronave të trashëgimisë kulturore.<sup>33</sup> Një nga të metat e këtij raporti është standardi i dyfishtë i aplikuar ndaj analizës së dëmtimit të trashëgimisë kulturore, me ç’rast ai fare nuk merret me periudhën e luftës (1998/99).

Të gjitha zhvillimet e rëndësishme pas ngjarjeve të marsit 2004 dhe këtij raporti, që kanë çuar edhe te formësimi i sistemit shtetëror të Kosovës së pavarur, janë bazuar mbi këto presime mjaft kontraktore të raportit të Kai Eide. Duke e injoruar gjithë historinë e mëparshme dhe bashkekzistencës fetare dhe etnike në Kosovë, ngjarjet e marsit 2004 janë marrë si e vetmja referencë për të gjitha masat që janë propozuar rreth Kosovës. Momenti kulmor i kësaj qasjeje ka qenë kodifikimi i këtyre masave në aneksin e pestë të Planit të Ahtisaarit.<sup>34</sup> Për më tepër, trashëgimia kulturore dhe fetare ka qenë edhe njëra nga gjashtë pikat e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki

---

ngjarjeve të Marsit 2004 pothuaj nuk ka patur asnjë rast të evidentuar të sulmeve ndaj objekteve fetare ortodokse në Kosovë

33 Raporti i Kai Eide për situatën në Kosovë, Institucionet dhe monumentet fetare ortodokse serbe, pikat 55 dhe 56, në <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>

34 Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, Aneksi V – Trashëgimia fetare dhe kulturore, në [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal\\_-\\_Propozimi\\_gjith%EBp%EBrfshir%EBs\\_-\\_albanian\\_final.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%EBp%EBrfshir%EBs_-_albanian_final.pdf)

Moon, të miratuar më 2008 nga Këshilli i Sigurimit.<sup>35</sup> Zhvillimi i fundit në këtë zinxhir procesesh është një marrëveshje e çuditshme e dialogut të fundit mes Kosovës dhe Serbisë e nisur në vitin 2013, sipas të cilës Policia e Kosovës do të themelojë një njësit special për trashëgiminë kulturore. Ky njësit special do të ofrojë mbrojtje për monumentet e trashëgimisë fetare ortodokse në Kosovë.<sup>36</sup>

Një nga dimensionet e harruara të këtij problemi është se Kisha Ortodokse Serbe ka një rol krejtësisht tjetër nga institucionet tjera fetare që veprojnë në Kosovë<sup>37</sup>. Që nga ardhja e Slllobodan Millosheviq në pushtet, roli i KOS u fuqizua tej mase, ndërsa udhëheqësit e saj anekënd ish-Jugosllavisë filluan të japin deklarata politike dhe të përdorin gjuhë të urrejtjes ndaj popujve të tjerë. Udhëheqësit më të lartë ushtarak dhe politik serb janë bekuar nga KOS para marshimeve të tyre vrastare<sup>38</sup>. Pas përfundimit të luftërave, roli dhe

35 Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohëshëm në Kosovë, S/2008/354, 12 Qershor 2008, në [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=S/2008/354](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/2008/354)

36 Koha Ditore, Zyrtarizohet njësit special për mbrojtjen e trashëgimisë, në <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,127368>

37 Për më tepër mbi rolin e KOS në rrjedhat politike në ish – Jugosllavi shi <http://www.bosnafolk.com/pdf/spc.pdf>

38 Ljubiša Rajić, Zašto Tadić sedi u Sinodu SPC?, në [http://www.danas.org/content/most\\_crkva\\_drzava/1889873.html](http://www.danas.org/content/most_crkva_drzava/1889873.html)

qëndrimet e KOS nuk ndryshuan fare<sup>39</sup>. Për më tepër, udhëheqësit e KOS vazhduan me të njëjtën gjuhë dhe me qëndrime armiqësore ndaj popujve të tjerë si dhe me mohimin e krimeve të kryera në emër të serbizmit gjatë viteve të 90. Kur i referohen Shqiptarëve, organet e KOS ende përdorin terma si “arbanas”<sup>40</sup>, dhe përkrahin qarqet ekstremiste dhe kriminele në veri të Kosovës.

39 Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, O cemu Crkva (ne) moze da se pita, në <http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Studija-Vu-komanovic.pdf>

40 Komunikatë e Kishës Ortodokse Serbe, Saopštenje za javnost Svetog Arhijerejskog Sinoda SPC, në <http://pravoslavljje.spc.rs/broj/1074/tekst/saopstenje-za-javnost-svetog-arhijerejskog-sinoda-spc/print/lat>



## V. Zona të Veçanta të Mbrojtura në vend të Zonave Rrethuese

kosovare u kërkua mbrojtja e mjediseve rrethuese përmes përcaktimit të zonave mbrojtëse (buffer zone) të rreth 47 pronave të trashëgimisë kulturore (shumica prej tyre kisha dhe manastire të besimit ortodoks që shfrytëzohen nga Kisha Ortodokse Serbe). Ky detyrim, i paraparë në Planin e Ahtisaarit, gjatë procesit të zbatimit nga ICO, përmes ndryshimeve joparimore dhe një ligji të veçantë, u transformua në vija të kuqe të ndarjes territoriale. Zonat rrethuese (buffer zone) rreth pronave të trashëgimisë kulturore u transformuan në Zona të Veçanta të Mbrojtura, duke i ofruar eksterritorialitet Kishës Ortodokse Serbe dhe Serbisë brenda territorit të Kosovës. Në emër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, duke u thirrur në Planin e Ahtisaarit, jashtë dispozitave të parapara me këtë dokument, në kundërshtim me parimet dhe praktikën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, zonat e veçanta të mbrojtura u shndërruan në instrument të pastër politik që betonizon dimensionin e etnisë brenda trashëgimisë kulturore.

Njëri ndër ligjet e para që derivojnë nga Planin e Ahtisaarit, i miratuar menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është Ligji për Zonat

e Veçanta të Mbrojtura.<sup>41</sup> Ky ligj u miratua tri ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në urgjencën dhe panikun legjislativ për të miratuar pa debat parlamentar dhe shoqëror, gjithçka sugjeronte Planin e Ahtisaarit. Ky ligj (si dhe Planin) ia shtronin rrugën edhe dy ligjeve të tjera, ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe atij për fshatin Hoçë e Madhe. Megjithatë, sipas KKTK, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura është në kundërshtim me sistemin e mbrojtjes ligjore dhe të administrimit të pronave të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Për më tepër, në një analizë të këtij këshilli konstatohet se “se Ligji për Qendrën Historike në Prizren, Ligji për fshatin Hoça e Madhe dhe Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nuk janë kërkesa të parashtruara në Planin e Ahtisaarit. Këto tri ligje janë produkt i ndryshimeve të parametrave të përcaktuara në Plan, të cilat ndryshime u bënë në mënyrë arbitrare nga bartësit dhe mbështetësit që përgatitën ligjet.”<sup>42</sup>

41 Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=146&Itemid=56&lang=sq](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=146&Itemid=56&lang=sq)

42 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Mbrojtja e Pronave të Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Kosovës

Seria e analizave “Çka shkoi ters?

Përveç ndryshimeve joparimore nga varianti fill-estar i këtyre zonave, një nga pasojat eventuale të krijimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura mund të jetë edhe e drejta e eksterritorialitetit të shtetit të Serbisë mbi territorin e Kosovës. Ky është një nga debatet e vazhdueshme në shoqërinë kosovare, e cila përveç tjerash bazohet në argumentin se shteti i Serbisë për një kohë të gjatë e ka instrumentalizuar Kishën Ortodokse Serbe për qëllime politike dhe pretendime territoriale.

## VI. Ndikimi i misionëve ndërkombëtare

Njëra ndër çështjet e nxehta politike, ku UNMIK-u kishte eksklusivitet vendimmarrjeje ishte edhe trashëgimia kulturore. Qasja përçmuese me dozë mosbesimi e misionëve ndërkombëtare ndaj aftësisë së kosovarëve për t'u kujdesur për trashëgiminë kulturore u ligjësuara në Planin e Ahtisaarit (rrjedhimisht në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës). Trajtimi i shoqërisë kosovare si shoqëri e paqytetëruar, ka prodhuar arrogancën e përfaqësuesit civil ndërkombëtar Peter Faith, si mbikëqyrës i pavarësisë dhe imponues i ligjeve të trashëgimisë kulturore, të cilat kanë hasur në reagime të fuqishme të shoqërisë kosovare.<sup>43</sup>

Raporti i Kai Eides ishte shumë eksplicit në lidhje me rolin e bashkësisë ndërkombëtare në trashëgimi kulturore. Kur i propozoi “zonat e mbrojtura”, ishte i bindur se këtë masë nuk mund të realizojnë institucionet e Kosovës. Prandaj, kërkoi një lloj mbrojtje ndërkombëtare për trashëgiminë

43 Dy nga këto reagime kanë ardhur nga Rahoveci dhe Prizreni, ku përmes nismave qytetare është synuar artikullimi i pakënaqësisë së qytetarëve ndaj imponimeve. Për detaje rreth aktivitetit të “Koalicionit ad-hoc të OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit”, mund të vizitoni <http://ecmandryshe.org/?page=1,11>

ortodokse në Kosovë.<sup>44</sup> Ajo që pasoi ishte një arrogancë e pashembullt e Zyrës Civile Ndërkombëtare karshi institucioneve shtetërore dhe shoqërisë kosovare në përgjithësi. Ndonëse mandati i ZCN ishte mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Ahtisaarit, në praktikë ajo u përfshi drejtpërdrejtë në qeverisjen, ndërsa konkretisht në shtyrjen e disa ligjeve të trashëgimisë kulturore.<sup>45</sup>

Në forma të ndryshme, ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare në trashëgimi kulturore vazhdon edhe sot. Në njërin nga rastet e fundit, udhëheqësi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Samuel Zbogar, i ka nxitur kryetarët e komunave të Prizrenit dhe Rahovecit që të ndërmarrin hapa konkretë në zbatimin e ligjeve për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Hoçën e Madhe.<sup>46</sup>

44 Raporti i Kai Eide për situatën në Kosovë, në <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>, Institucionet dhe monumentet fetare ortodokse serbe, pikat 56

45 Në një rast konkret, shefi i ZCN, Peter Faith, bashkë me Kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçi, kishin marrë pjesë disa ditë rresht në takimet e komisionit përkatës parlamentar, derisa po bëhej shqyrtimi i projektligjeve për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe. Për këtë presion, Zëri, Thaçi e Faith sulmojnë Prizrenin, në <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/33192/thaci-e-feith-sulmojne-prizrenin/>

46 Koha Ditore, Zbogar kërkon zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në <http://www.koha.net/?page=1%2C13%2C132345>

Kjo dhe të tjerat raste të ngjashme janë dëshmi se edhe pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk ka ndryshuar qasja mosbesuese e bashkësisë ndërkombëtare ndaj pjekurisë shoqërore dhe shtetërore të Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Është vështirë t’i bëhet diagnozë e saktë kësaj situatë, e sidomos të përcaktohen shkaktarët e saj. Kjo për shkak se një detaj shumë i rëndësishëm i saj lidhet me nënshtrimin total të institucioneve shtetërore të Kosovës ndaj “këshillave” që kanë ardhur nga ndërkombëtarët në lidhje me trashëgiminë kulturore (dhe jo vetëm). Ka patur shumë deputetë të Kuvendit e zyrtarë të qeverisë që kanë folur për interferimet e bashkësisë ndërkombëtare, deri në hartimin e plotë të teksteve të ligjeve dhe politikave të tjera. Të vendosur para aktit të kryer, zyrtarët institucional të Kosovës janë treguar skajshmërisht të ngathtë dhe në të njëjtën kohë servilë ndaj – siç i quajnë ata në ligjërimin publik – këshillave të miqve ndërkombëtarë.

## VII. Plani kombëtar dhe politikat e trashëgimisë kulturore

Kosova ende nuk e ka një politikë shtetërore për trashëgiminë kulturore. Ajo që ekspertët i referohen si Plan Kombëtar për Trashëgimi Kulturor, është një dokument qendror i orientimeve strategjike në këtë sektor. Mungesa e një plani të tillë ka krijuar rrëmujën aktuale në menaxhimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Në të njëjtën kohë, në mungesë të planifikimit strategjik, trashëgimia kulturore dështon të sigurojë edhe alokim më të madh fondesh publike nga buxheti shtetëror. Sipas Skënder Boshtrakajt, Ligji për Trashëgiminë Kulturor është i paqartë, nuk ka udhëzues praktik për zbatim dhe se nga ky ligj nuk ka derivuar një strategji për këtë sektor. Krahas kësaj, ai konstaton një mungesë të theksuar kapacitetesh institucionale dhe mungesën e mbështetjes së duhur për konsolidimin e këtij kapaciteti.<sup>47</sup>

Përveç ligjit bazë për trashëgiminë kulturore, MKRS ka nxjerrë edhe shtatë akte nënligjore, të cilat mëtojnë të rregullojnë obligimet ligjore të këtij sektori. Aktet nënligjore të miratuara në vitin 2008 përfshijnë këto fusha: gërmimet arke

47 Skënder Boshtrakaj, diskutime në fokus grupin "Çka shkoi ters në trashëgimi kulturore", mbajtur më 9 tetor 2012 në Prishtinë

ologjike, qasjen publike në trashëgiminë kulturore në pronësi private, konservimet dhe restaurimet, Inspeksionin, mbrojtjen ligjore, trashëgiminë e luajtshme, licensimin për aktivitet komercial.<sup>48</sup> Përkundër kësaj kornize ligjore, vitin e kaluar MKRS, duke konstatuar moszbatimin efektiv të legjislacionit në trashëgimi kulturore, inicioi rishkrimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturor. Sipas ndryshimeve të propozuara, në ligjin e ri parashihen këto masa kryesore: koncesionimi i pronave të trashëgimisë kulturore, Inspektorati i trashëgimisë kulturore dhe shndërrimi i KKTK në organ qeveritar.<sup>49</sup>

Një nga politikat më thelbësore të trashëgimisë kulturore, e miratuar nga MKRS në shtator të vitit 2010 në formën e dokumentit strategjik është ajo mbi konservimin e integruar.<sup>50</sup> Këtij dokumenti të politikave i kishte paraprirë një Strategji Konservimi për Trashëgiminë Kulturorë

48 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Legjislacioni, në <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,15>

49 Projektligji i ri për trashëgiminë kulturore, përkundër premtimeve të Ministrisë se do të miratohet në vitin 2012, ende nuk është proceduar në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim parlamentar.

50 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Dokument Strategjik, Konservimi i integruar i tërësive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës



në Kosovë, e prodhuar në vitin 2005. Kjo strategji pëmbante këto rekomandime: ridefinimi i përgjegjësive institucionale, themelimi i departamentit të trashëgimisë kulturore, kompletimi i kornizës ligjore, koordinimi i donatorëve, inventari i pronave të trashëgimisë kulturore dhe edukimi. Një tjetër dokument i politikave në këtë sektor është edhe Doracaku mbi menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë, i prodhuar në vitin 2007 për të përshkruar hapat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në përputhje me standardet ndërkombëtare për formulimin e politikave të menaxhimit. Së fundmi, është prodhuar edhe Udhëzuesi mbi Trashëgiminë Kulturore (mjetet teknike për konservim dhe menaxhim të trashëgimisë), si një pikënisje për vendosjen e standardeve dhe masave të trashëgimisë për të nxitur përfshirjen aktive të autoriteteve shtetërore, profesionistëve dhe komunitetit në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Të gjitha këto dokumente të politikave kanë një emërues të përbashkët, qasjen e integruar. Prandaj, politika e konservimit të integruar paraqet domosdoshmërinë për koordinim institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Një qasje e tillë presupozon se trashëgimia kulturore është përgjegjësi shumë më e gjerë se sa e një institucioni të vetëm. Konservimi i integruar ka të bëjë me bashkëpunimin ndërsektoral mes organeve të ndryshme publike administrative, si dhe me koordinimin e masave legislative në mënyrë që të plotësojnë dhe zgjerojnë njëra tjetrën.<sup>51</sup> Konkretisht, struktura institucionale e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë, përtej kompetencave të MKRS, përfshin edhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe qeveritë lokale. Në këtë pikë, mund të shihet më së miri paaftësia e institucioneve të Kosovës për të krijuar një strukturë shtetërore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në të njëjtën kohë, kjo situatë është dëshmi dhe pasojë direkte e mungesës së një Plani Kombëtar në këtë sektor. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, organ ligjor për mbështetjen e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ka përgatitur udhëzuesin për Politikën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore (2011). Përgatitja e kësaj politike shumësektoriale është në varshmëri të mbështetjes së

51 Baza e parimeve të konservimit të integruar për herë të parë u vendos në Kartën Evropiane të Trashëgimisë Arkitekturale dhe Deklaratën e Amsterdimit, miratuar në vitin 1975 nga Komisioni i Ministrave i Këshillit të Evropës

specializuar profesionale, dhe ka koston e vet financiare, i cili fond ende nuk është siguruar. graduese.<sup>53</sup>

Përfundimisht, pa zbatimin e politikave të konservimit të integruar nuk do të mund të ndërtojmë një sistem funksional të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Dështimi për të ndërtuar një qasje sistematike ndaj trashëgimisë kulturore ka prodhuar tensione të vazhdueshme mes interesave konkurruese: mes ruajtjes dhe rritjes, traditës dhe modernizimit, artizanales dhe inovacionet. “Menaxhimi i trashëgimisë kulturore me të vërtet ka një ndikim të rëndësishëm në territor, në lidhje me dimensionet e tij themelore, siç janë: rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës, peizazhi dhe ruajtja e mjedisit, dhe infrastruktura.”<sup>52</sup> Sipas Rozafa Bashës, trashëgimia kulturore ka mbetur jetime, pasi që askush nuk është i interesuar ta integrojë atë në tregun ekonomik. Për më shumë, ajo konstaton mungesën e planeve të menaxhimit, pasi të kryhen intervenimet në trashëgimi kulturore, duke i shndërruar ato në investime të vdekura dhe de-

---

52 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Dokument Strategjik, Konservimi i integruar i tërësive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës

---

53 Rozafa Basha, diskutime në fokus grupin “Çka shkoi ters në trashëgimi kulturore”, mbajtur më 9 tetor 2012 në Prishtinë



## VIII. Mungesa e inventarit shtetëror

Vitin e kaluar Ministria e Kulturës ka miratuar listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohëshme.<sup>54</sup> Kjo ishte një zgjidhje e përkohëshme dhe arruete ndaj problemit të madh në këtë sektor: ne ende nuk e kemi idenë se çfarë pasurie dhe potenciali të trashëgiminë kulturore posedojmë. Inventari shtetëror është premtim i para dhjetë viteve, që nuk është realizuar kurrë. Si pasojë, Kosova nuk mund të shpallë në mbrojtje ligjore asnjë pronë të trashëgimisë kulturore. I njëjti veprim u përsërit edhe në fund të vitit 2012, kur MKRS e prolongoi për një vit vlefshmërinë e listës së pronave në mbrojtje të përkohëshme.<sup>55</sup>

Ky është një nga dështimet më të mëdha të mbrojtjes ligjore në sektorin e trashëgimisë kulturore, ndërsa arsyetimi më i zakonshëm i MKRS lidhet me mosfunksionalizimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.<sup>56</sup> Sipas Ligjit të

54 Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme, në [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi\\_2\\_-\\_Lista\\_e\\_perkohshme\\_e\\_trashigimis\\_kulturore.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Aneksi_2_-_Lista_e_perkohshme_e_trashigimis_kulturore.pdf)

55 Koha Ditore, Mosmarrëveshjet institucionale lënë trashëgiminë pa mbrojtje të përhershme, në <http://www.koha.net/?page=1,5,118118>

56 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor (KGTK) është autoritet ligjor për mbrojtje të trashëgimisë kulturore i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i KGTK është vlerësimi dhe përcaktimi i pronave të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës në mbrojtje të përhershme (në funksion të krijimit të listës së trashëgimisë kulturore). Më shumë, në <http://mem.rks-gov.net/>

Trashëgimisë Kulturore<sup>57</sup>, ky Këshill funksional ka rol qendror në sistemin e mbrojtjes së përhershme të trashëgimisë kulturore. Në bazë të propozimeve nga MKRS, persona fizik dhe juridik, bënë vlerësimin, rishikimin dhe shpalljen e pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Ndërkaq, MKRS deri me sot nuk ka dorëzuar asnjë vlerësim, prandaj si pasojë në vendin tonë pronat e trashëgimisë kulturore nuk janë të shpallura në mbrojtje, ndërsa si pasojë nuk mund të krijohet Lista e Trashëgimisë Kulturore e Republikës së Kosovës. Në vend të përgatitjes së propozimeve për vlerësim dhe shpallje të pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, MKRS ka ndërmarrë një veprim improvizues dhe joefektiv, duke krijuar një Listë në trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohëshme, e cila nuk është në përputhje me parametrat ligjor, prandaj dhe si instrument nuk hyn në funksion të mbrojtjes efektive dhe aktive. Në hartimin e Ligjit të ri të trashëgimisë kulturore (i pamiratur), nga një institucion i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, KGTK do të kalojë nën au

57 Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, në [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=237&Itemid=28&lang=sq](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=237&Itemid=28&lang=sq)

toritetin e MKRS. Ky veprim është kundërshtuar fuqishëm nga udhëheqësja e KKTK, Edi Shukriu, duke e vlerësuar “shqetësuese tendencën që Këshilli të futet nën mbikëqyrjen e Ministrisë dhe ministrit”.<sup>58</sup> Ajo argumenton se KKTK është organ i pavarur dhe profesional, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe që duhet mbi të gjitha të mbikëqyrë punën e ekzekutivit.

Sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, identifikimi dhe përcaktimi i potencialit të trashëgimisë kulturore si pronë e mbrojtur bëhen nga autoritetet e trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me autoritetet e planifikimit hapësinor. Sipas ecures së proceseve të mbrojtjes, pronat e trashëgimisë kulturore identifikohen, regjistrohen, dokumentohen, vlerësohen, propozohen dhe përcaktohen për mbrojtje përmes sistemit të Invenatrit Shtetëror. Përcaktimi i pronave të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme apo të përherëshme bëhet me vlerësime nga autoritetet e trashëgimisë kulturore. Paraqitja e propozimeve për mbrojtje bëhet nga personat fizik dhe juridik, me dokumentacion të mirëfillt. Pronat e trashëgimisë kulturore të përcaktuara për mbrojtje regjistrohen në

58 Koha Ditore, Shumë vërejtje përprojektligjin e ri për trashëgimi kulturore, në <http://www.koha.net/?page=1,5,112029>

Listën e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Kosovës.<sup>59</sup> Për më tepër, në shtator të vitit 2008, MKRS pat miratuar Rregulloren mbi regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, si një përpjekje për të konkretizuar nenet e Ligjit për Trashëgimi Kulturore mbi inventarizimin.<sup>60</sup>

Një nga projektet më të ngadalshme të MKRS është ai i databazës së trashëgimisë kulturore, i filluar në vitin 2008 dhe i financuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë. Qëllimi i këtij projekti është të bëhet evidentimi i pronave të trashëgimisë kulturore, të cilat pastaj do të gëzojnë mbrojtje ligjore. Pothuaj pesë vite pas nisjes së këtij projekti, zyrtarët e Ministrisë vazhdojnë të japin premtime për përfundimin e tij, ndërsa çdo zhagitje e mëtutjeshme do të ketë pasoja direkte në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<sup>61</sup>

59 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Mbrojtja e Pronave të Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Kosovës

60 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rregullore mbi regjistrimin, dokumentimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, në <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,15>

61 Koha Ditore, Për katër vjet vetëm gjysma e databazës së trashëgimisë, në [http://www.kohaditore.com/index.php/repository/karikaturat/repository/docs/Raporti\\_per\\_Veri\\_Maj\\_2011?page=1,5,99586](http://www.kohaditore.com/index.php/repository/karikaturat/repository/docs/Raporti_per_Veri_Maj_2011?page=1,5,99586)

## IX. Intervenimet e vonuara emergjente

Neglizhenca institucionale ndaj trashëgimisë kulturore më së miri vërehet në trajtimin që gëzojnë shtëpitë e vjetra. Si pasojë e moskujdesit, pjesa më e madhe e shtëpive të vjetra qytetare vijnë në gjendje të pakthyeshme dëmtimi. Zgjidhja e lehtë që kërkohet në këto raste është rrënimi i tyre, i cili jo rrallë bëhet edhe me arsyetimin “për sigurinë e qytetarëve”. Ka shumë monumente të rëndësishme të cilat kanë nevojë për intervenime emergjente, ndërsa institucionet janë tërësisht interte. Paradoksalisht, një pjesë e madhe e intervenimeve në monumente të trashëgimisë kulturore nuk e përfillin kriterin e urgjencës.

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore “Monumentet arkitekturale ose ndërtesat brenda asambleve që janë në një gjendje të keqe të riparimit ose janë në rrezik të dëmtimit domethënës bëhen objekt i një procedure riparuese urgjente ose emergjente. Institucioni kompetent i dërgon pronarit një njoftim të shkruar në afat shtatë ditësh me qëllim të hyrjes në objekt për të ndërmarrë një punë të tillë.”<sup>62</sup> Edhe pse në Kosovë ekziston

62 Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Neni 6, Trashëgimia Arkitekturale, në [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=237&Itemid=28&lang=sq](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=237&Itemid=28&lang=sq)

një nevojë e madhe për intervenime emergjente, MKRS vetëm në vitin 2012 ka marrë iniciativën për krijimin e një liste të tillë. Vlera totale e buxhetit për këtë veprim ka qenë 200 mijë euro, ndërsa në listën e parë të hartuar gjendeshin 31 monumente të trashëgimisë kulturore.<sup>63</sup>

Pas përfundimit të procesit të tenderimit dhe përzgjedhjes së punëkryerësve është evidentuar një mangësi tjetër në intervenimet emergjente. Të gjithë përfituesit e këtij tenderi janë kompani ndërtimore, të cilat nuk janë të specializuara në restaurime. Sipas Gjejlane Hoxhës, Kosova nuk ka sistem të licencimit që do të nxirrte ekspertë në këtë fushë. Për më tepër ajo konstaton se paralelisht me intervenimin emergjent, duhet të shkojë edhe hartimi i planit për konservim, ndërsa këtë punë nuk mund ta bëjnë kompanitë ndërtimore.<sup>64</sup>

Fondet publike në dispozicion të trashëgimisë kulturore në përgjithësi, dhe rrjedhimisht ato për intervenime emergjente në veçanti janë nën minimumin e nevojave të këtij sektori. Institucionet

63 Koha Ditore, Tridhjetë objekte të trashëgimisë kulturore në listë për ndërhyrje emergjente, në <http://koha.net/index.php?page=1,5,114209>

64 Koha Ditore, Ndërhryjet emergjente në trashëgimi në duar të kompanive ndërtimore, në <http://www.koha.net/?page=1,5,119530>

e shtetit ende nuk e kanë një politikë shtetërore mbi trashëgiminë kulturore, përmes së cilës do të bëhej planifikimi strategjik i trashëgimisë kulturore. Kultura vazhdon të mos jetë prioritet për institucionet e shtetit të Kosovës. Investimi në kulturë dhe trashëgimi kulturore i qeverisë së Kosovës përbën më pak se 1% të buxhetit vjetor të Kosovës.<sup>65</sup> Qeveria e Kosovës investon në kulturë rreth 5 euro për kokë banori në vit<sup>66</sup>, ndërsa në nivelin komunal gjendja është edhe më e vështirë. Në Prizren, që është komuna më e pasur në kuptimin e trashëgimisë kulturore dhe konkurrenente ndaj Prishtinës për jetën kulturore, qeveria lokale investon në kulturë më pak se 1% të buxhetit vjetor (ose rreth 2 euro për kokë banori).<sup>67</sup>

Një pjesë e konsiderueshme e intervenimeve restauruese në trashëgimi kulturore është reali-

65 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, 1 janar 2012, në <http://www.gazetazyrtare.com/>

66 Kosova është afër vetëm Shqipërisë në këtë aspekt, e cila investon në kulturë 6 euro për kokë banori në vit. Të dhënat për shtetet e tjera të Evropës: Maqedonia 24 euro, Serbia 24 euro, Sllovenia 135 euro, Suedia 235 euro dhe Danimarka 294 euro. Burim: Compendium, Cultural policies and trends in Europe, në <http://www.culturalpolicies.net/web/countries.php>

67 Komuna e Prizrenit, Buxheti për vitin 2011 dhe për vitet 2011-2013, miratuar më 23 shtator 2010, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Projects/Budget/Buxheti20112013.pdf.aspx>

zuar përmes donacioneve të jashtme. Kultura institucionale për t'i dhënë ‘po’ secilit donacion të jashtëm që vjen në emër të asistencës zhvillimore për Kosovën, është evidentuar edhe në projekte restaurimi për trashëgiminë kulturore. Në emër të një donacioni të këtillë, institucionet e Kosovës kanë hequr dorë nga e drejta dhe obligimi për të përcaktuar desitininimin e donacionit, caktuar kriteret e intervenimit dhe mbikëqyrur punët e restaurimit. Si pasojë e kësaj ‘pavarësie’ të palës donatore (agjenci shtetërore, organizatë ndërkombëtare, filantropi private), janë përdorur metodologji të ndryshme të konservimit. “Derisa agjencia shtetërore turke TIKa mbështetet kryesisht në profesionistë turq dhe zejtarë, organizata suedeze CHwB ka tendencë për të trajnuar mjeshtrit vendas në projektet e tyre.”<sup>68</sup> Sipas Sali Shoshit, në mungesë të një plani kombëtar, tërë këto vite kemi patur intervenime të pakoordinuara të donatorëve të shumtë në trashëgimi kulturore.<sup>69</sup>

68 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Dokument Strategjik, Konservimi i integruar i tërësive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës

69 Sali Shoshi, diskutime në fokus grupin “Çka shkoi ters në trashëgimi kulturore”, mbajtur më 9 tetor 2012 në Prishtinë

## X. Shkatërrimi i Qendrës Historike të Prizrenit

Para 30 vitesh, qyteti i vjetër i Prizrenit ishte një vlerë konkurrense për t'u përfshirë në listën botërore të trashëgimisë të UNESCO-s. Dhjetë vitet e fundit e kanë transformuar në masë të frikshme strukturën urbane të qytetit të Prizrenit.<sup>70</sup> Ky fat, që i ka përcjellë edhe qytete të tjera historike nëpër botë, nuk është trend i pakthyesëm. Ka qytete historike, të cilat janë zhdukur pothuaj tërësisht nga luftërat dhe sot kanë arritur të rikonstruktohen tërësisht. Megjithatë, trendet e urbanizimit të egër në Prizren janë intervenime që shkaktohen nga qeveria e qytetit dhe ndërtuesit. Për më tepër, nuk ka tregues pozitiv se ky trend është duke u ngadalësuar. Derisa intervenimet në trashëgiminë kulturore kanë qenë selektive dhe kryesisht të ralizuar nga fondet e jashtme të ndihmës zhvillimore, Prizreni sot, krahasuar me një dekadë më parë, i ngjan më shumë një qendër moderne tregtare dhe banimi, se sa një qyteti historik.

Në një nga hulumtimet e projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit” është raportuar se vetëm në gjashtë mujin e parë të vitit 2012 nga

Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren janë lëshuar 62 pëlqime për ndërtim apo ndërhyrje në Qendrën Historike të Prizrenit. Shqetësues mbetet fakti që në një numër të konsiderueshëm ndërtimesh nuk respektohen projektet origjinale dhe leja e punës së lëshuar nga autoritetet komunale. Ky Institut edhe pse nuk e ka për obligim të procedojë kërkesa pranë Drejtorisë së Inspekcioneve, në tri vitet e fundit ka dërguar më se 25 kërkesa për ndërprerjen e punimeve apo edhe rrënimin e tyre për mos respektim të projektit në pajtim me pëlqimin e lëshuar nga Instituti dhe në pajtim me parimet e trashëgimisë kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit.<sup>71</sup> Dëshmia më e mirë për degradimin urbanistik të Prizrenit është shkresa zyrtare me Nr. 04-353 e Drejtorisë së Urbanizimit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit, në të cilin, në mes tjerash thuhet se “në bazë të evidencës që posedon shërbimi i DUPH ju njoftojmë se ndërtimet të cilat janë duke u zhvilluar kohëve të fundit janë mjaft shqetësuese; ato të cilat kanë leje ndërtimi mbi 80% nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit ndërsa një numër shumë i madh i ndërtimeve tjera janë pa kurrfarë

70 EC Ma Ndryshe, Deurbanizimi i Qendrës Historike të Prizrenit, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_4.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_4.pdf)

71 EC Ma Ndryshe, Dëshmitë e degradimit urban të Prizrenit, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate\\_6.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_6.pdf)



leje të ndërtimit.<sup>72</sup>

Prizreni është një rast tipik i dështimit të institucioneve të shtetit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Degradimi i vlerave të Qendrës Historike të qytetit ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore nga të dyja nivelet e qeverisjes. Derisa MKRS nuk e ka kryer obligimin e vet mbikëqyrës, qeveria lokale e Prizrenit ka qenë e paaftë në parandalimin e veprimeve shkatërruese të ndërtuesve në dëm të trashëgimisë kulturore. Më keq se kaq, qeveria lokale e Prizrenit, me shpërfilljen e ligjeve, Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit<sup>73</sup> dhe planeve rregullative urbane,<sup>74</sup> ka qenë kontribuesi kryesor në procesin e zhdukjes së vlerave kulturore dhe historike të qytetit.

---

72 EC Ma Ndryshe, Deurbanizimi i Prizrenit, në <http://www.online-transparency.org/?page=1,42,10>

73 Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/25fdb992-4fa8-4623-9811-ae22a0bd6b2a/Plani-i-Konservimit-dhe-Zhvillimit-te-Zones-Histor.aspx>

74 Komuna e Prizrenit, Planet Rregullative, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Projects/Planet-Rregullative.aspx>

## Rekomandime

Rekomandimet e analizës janë një thirrje për mobilizim të gjerë shtetëror dhe shoqëror për të shëruar sëmundjet e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ato janë konkrete, të zbatueshme lehtësisht, të hartuara në konsultim me ekspertët përkatës dhe i drejtohen: Kuvendit të Kosovës, Autoriteteve të Trashëgimisë Kulturore, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qeverisë së Kosovës, komunave të Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

### **Për Kuvendin e Kosovës dhe Autoritetet e Trashëgimisë Kulturore**

- Hartimi i Planit Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore – korniza ligjore dhe politikat e trashëgimisë duhet të jenë të koordinuara dhe të rrjedhin nga një politikë qendrore kombëtare. Përmes Planit Kombëtar me qasjen e integruar si shtyllë qendrore, Kosova do të krijojte sistemin e menaxhimit të trashëgimisë kulturore,
- Shpallja e pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje – trashëgimia kulturore duhet të

gëzojë mbrojtje ligjore, ndërsa detyrë primare e autoriteteve të trashëgimisë kulturore dhe e Kuvendit të Kosovës është shpallja e pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje. Në mungesë të kësaj garancie ligjore të mbrojtjes, trashëgimia kulturore është e dënuar të shkatërrohet.

### **Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

- Përgatitja e Strategjisë/Programit për zbatim të konservimit të integruar të trashëgimisë kulturore, përmes krijimit të inventarit emergjent të trashëgimisë kulturore në funksion të shpalljes së pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, përfshirjes në Listën e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Kosovës, në Planin Hapësinor të vendit dhe planet zhvillimore komunale e urbane,
- Mbikëqyrje efektive e respektimit të parimeve të trashëgimisë kulturore në komuna – sektori i urbanizmit në komunat e Kosovës, sidomos në ato me vlera të trashëgimisë kulturore,

duhet të ketë mbikëqyrje rigorize në raport me respektimin e ligjeve dhe politikave të trashëgimisë kulturore,

- Përfundimi i inventarit shtetëror dhe mbrojtja e përhershme e trashëgimisë kulturore – inventari do të ishte në funksion të identifikimit, vlerësimit dhe përcaktimit të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme dhe për krijimin e Listës së Trashëgimisë Kulturore,
- Ngritja e kapaciteteve dhe rritje e buxhetit për trashëgimi kulturore – Departamenti i sapo themeluar i Trashëgimisë Kulturore duhet të plotësohet me kapacitete të reja, posaçërisht në hartimin e politikave dhe përkthimin e standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore në praktikën kosovare.

### **Për Qeverinë e Kosovës**

- Kushtëzimi i dialogut me Serbinë me kthimin e artefakteve të grabitura – pasuria arkeologjike dhe etnologjike e Kosovës duhet të kthehet sa më shpejt, ndërsa dialogu aktual me Serbinë është moment i duhur për të kërkuar kthimin e

artefakteve që padrejtësisht vazhdojnë të mbahen në Serbi,

- Vlerësimi i mundësive alternative për vendosje të marrëdhënieve me UNESCO-n – anëtarësimi në OKB nuk është arsye e mjaftueshme për të mos kërkuar rrugë alternative drejt UNESCO-s (një rast konkret është ai i Autoritetit Palestinez),
- Intensifikimi i aktiviteteve për ratifikimin e konventave ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore – përmes ratifikimit të konventave ndërkombëtare në Kuvendin e Kosovës, institucionet e shtetit do të merrnin njanshëm përsipër obligime ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Për më tepër, shumë nga parimet që gjenden në këto konventa do të bëhen pjese e kornizës ligjore dhe e politikave të Kosovës,
- Prioritizimi i trashëgimisë kulturore si politikë publike me interes kombëtar – trashëgimia kulturore duhet të konsiderohet si potencial strategjik kombëtar për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës,

- Plotësimi i programeve shkollore me lëndën e trashëgimisë kulturore – vetëdijesimi mbi rëndësinë dhe potencialin zhvillimor të trashëgimisë kulturore duhet të fillojë në shkollat fillore dhe të mesme, përmes dizajnit të një lënde të veçantë për trashëgiminë kulturore.

### **Për komunat e Kosovës**

- Respektimi i përpiktë i Instituteve për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës – çdo pëlqim i lëshuar nga IMMK-të duhet të jetë detyrues për komunat e Kosovës, pasi që ato bazohen në standardet ndërkombëtare dhe ligjet shtetërore të trashëgimisë kulturore. Prandaj, çdo tejkallim i masave të parapara me pëlqime të IMMK-ve duhet të pengohet dhe/ose të ndëshkohet nga autoritetet komunale të Kosovës,
- Hartimi i planeve lokale të trashëgimisë kulturore – përmes planifikimit strategjik të trashëgimisë kulturore, komunat do të vëllirizojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin lokal ekonomik. Planet lokale të trashëgimisë kulturore do të hapin rrugë edhe për koordinim më të mirë ndër-sektoral bazuar në parimet e konservimit të integruar,
- Koordinim efektiv mes drejtorive për urbanizëm dhe inspektorat – dështimi për të komunikuar mes këtyre dy sektorëve është fatal për trashëgiminë kulturore, prandaj Kryetarët e komunave me potencial të trashëgimisë kulturore, duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë koordinimit të urbanizmit dhe inspektoratit në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkallimeve të tjera,
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane – trashëgimia kulturore duhet të jetë komponentë qendrore e planifikimit urban në komunat me potencial të trashëgimisë. Gjatë hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale, Planeve Zhvillimore Urbane dhe Planeve Rregullative Urbane, komunat duhet të respektojnë të gjitha parimet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje në qendrat historike të qyteteve – për të parandaluar zh-

dukjen totale të qendrave historike të Kosovës, autoritetet komunale duhet të ndërmarrin veprime konkrete për rrënimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të tjera që janë në kundërshtim me parimet e trashëgimisë kulturore.

sdoshëm në këtë drejtim është ndryshimi i ligjërimit publik që e bashkon trashëgiminë me etninë. Për më tepër, nuk duhet toleruar më tej që trashëgimia kulturore të jetë në mesin e kërkesave të Serbisë ndaj Kosovës.

### **Për bashkësinë ndërkombëtare**

- Të kuptojë rolin e saj dhe të ndryshojë qasjen kundrejt trashëgimis kulturore të Kosovës – misionet ndërkombëtare në Kosovë duhet të rikonsiderojnë qasjen e tyre ndaj shtetit dhe shoqërisë kosovare në raport me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
- Ofrimi i mbështetjes profesionale – në vend të imponimit të politikave në këtë sektor, bashkësia ndërkombëtare duhet të ndihmojë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe të asistojë në anëtarësimin e Kosovës në mekanizma ndërkombëtar të trashëgimisë kulturore,
- Depolitizimi i trashëgimisë kulturore – trashëgimia kulturore ka nevojë t’i kthehet dimensionit të vet vleror, ndërsa hap i domo-

### **Për shoqërinë civile**

- Mobilizimi i grupeve qytetare lokale kundër degradimit urban të qyteteve – organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal duhet të angazhohen në nxitjen e aktivizmit qytetar për t’i shpëtuar vlerat e trashëgimisë kulturore në qytetet dhe fshatrat e Kosovës,
- Angazhimi në projekte vetëdijesimi mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore – shoqëria civile duhet të angazhohet në programe të edukimit joformal mbi trashëgiminë kulturore, ndërsa paralelisht duhet t’i nxisë institucionet shtetërore për përfshirjen e trashëgimisë kulturore në programet zyrtare të shkollave fillore dhe të mesme.





Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Projekat Kosovske Fondacije za Otvoreno Društvo  
Project of the Kosovo Foundation of Open Society

